



REPUBLIKA E KOSOVËS	REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE	OSNOVNI SUD
G.J.A-Su.A	01/2025
Dt:	09.01.2025
GJILAN - GNJILANE	

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

PLANI DHE PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2025

Plani dhe Programi i Punës 2025

Objektivat e menaxhmentit të Gjykatës Themelore në Gjilan

Përbledhje

Plani i Punës për vitin 2025:

- I. Përcaktimi i numrit të gjyqtarëve brenda departamenteve dhe divizioneve, proporcional me numrin e lëndëve të cilat janë të pa trajtuar brenda gjykatës
- II. Përcaktimi i numrit të bashkëpunëtorëve brenda departamenteve dhe divizioneve proporcional me numrin e lëndëve të cilat janë të pa trajtuar brenda gjykatës.
- III. Përcaktimi i objektivave dhe përgjegjësive të të punësuarve brenda administratës së gjykatës, përfshirë efikasitetin në punë.
- IV. Përcaktimi i kalendarit vjetor të mbledhjeve të kolegjiumit të gjyqtarëve të gjykatës dhe kolegjiumit të gjyqtarëve të Degës
- V. Përcaktimi i kalendarit vjetor të takimeve të rregullta me bashkpunitorët profesional dhe administrativ.
- VI. Krijimi i trupave brenda gjykatës dhe Degës përfshirë siguruar skanim të hershëm të parashtresave të pranuara në gjykatë.
- VII. Zbatimi i Programit SMIL për regjistrimin e lëndëve, caktimin e seancave, vendosjen e akteve procedurale si dhe akteve finale, duke siguruar kualitetin të dhënave respektivisht përpjekje të plotë të dosjes fizike me dosjen elektronike, dhe atë nga faza e pranimit të lëndës, trajtimit e deri te arkivimi.
- VIII. Zbatimi i Sistemit të Evidencës Penale, duke siguruar vendosje të drejtë brenda afateve, në pajtim të plotë me aktin gjyqësor.
- IX. Kalendari i mbajtjes së seancave efektive (bllok) përfshirë trajtuar lëndët me efikasitet.
- X. Evitimi i shtyerjes dhe anulimit të seancave, duke siguruar që seancat e planifikuara të mbahen në salla të gjykimeve.
- XI. Zbatimi i programit për audio dhe video inçizim të seancave në sallat e gjykimit në fushën penale.
- XII. Publikimi i akteve gjyqësore meritore, e të cilat nuk kanë kufizime përfshirë publikim
- XIII. Respektimi i afateve përfshirë dërgimin e lëndëve në gjykatën e shkallës së dytë dhe tretë.

- XIV. Ekzekutimi me kohë i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, përfshirë edhe vendimet gjyqësore nga lëmia e kundërvajtjeve
- XV. Zbatimi i planit të trajnimeve nga bashkëpunëtorët dhe administrata
- XVI. Vlerësimi i përformancës së punës së bashkëpunëtorëve
- XVII. Vlerësimi i përformancës së punës së zyrtarëve të administratës.
- XVIII. Zbatimi i rekomandimeve ZKA si dhe planit për adresimin e rekomandimeve të SKGJK-së, për menaxhimin e pasurisë, vlerësimin e përformancës, inventarizimit, zhvlerësimit dhe asgjësimit të pasurisë.
- XIX. Zbatimi i Planit Strategjik të KGJK-2022-2025, Planit Strategjik 2022-2025 për përmirësimin e Qasjes në Drejtësi, Planit strategjik për trajtimin e lëndëve kundër korruptionit, Planit strategjik për komunikim me media dhe planet tjetra strategjike të miratuara nga KGJK
- XX. Zbatimi i plotë i legjislacionit për respektimin e gjuhëve zyrtare edhe me rastin e mbajtjes së seancave gjyqësore, trajtimit të lëndëve si dhe adresimit të akteve gjyqësore.
- XXI. Zbatimi i akteve të KGJK-së, lidhur me organizmin e brendshëm dhe menaxhimin e punës së gjykatave, përformancën e gjykatave, si dhe normën e punës së gjyqtarëve.
- XXII. Plani për drejtësi procedurale në gjykata
- XXIII. Ruajtja dhe arkivimi i lëndëve brenda gjykatës si dhe dorëzimi i lëndëve të cilat i plotësojnë kushtet, në agjensinë shtetërore të arkivave
- XXIV. Zbatimin e rekomandimeve që dalin nga raportet inspekuese të përgatitura nga NJIGJ të cilët monitorojnë punën e gjyqësorit.
- XXV. Zbatimin e rekomandimeve që dalin nga raportet e përgatitura nga monitorimet e realizuara nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore, të cilat monitorojnë punën e gjyqësorit, si dhe planeve për adresim të rekomandimeve nga KGJK.
- XXVI. Zbatimi i udhëzuesit për politikën ndëshkimore me qëllim të krijimit të praktikës së uniformitetit në shqiptimin e dënimive brenda sistemit gjyqësor.

Plani dhe Programi i Punës 2025

- XXVII. Zbatimi i udhëzuesit për referimin e rasteve në procedurë të ndërmjetësimit si mjet alternativ për zgjidhjen e lëndëve.
- XXVIII. Zbatimi i udhëzuesit për shpërndarjen e shkresave duke evitar mundësinë e dështimit të seancave.
- XXIX. Hartimi i planit për monitorimin e punës së gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve dhe administratës nga Kryetari i Gjykatës.
- XXX. Hartimi i raporteve periodike për KGJK-në bazuar në rezultatet e treguara, si dhe sfidave eventuale të paraqitura gjatë punës brenda gjykatës.
- XXXI. Hartimi i raporteve lidhur me zbatimin e rekomandimeve të pranuara nga NJIGJ.
- XXXII. Hartimi i raporteve që dalin nga monitorimet e realizuara nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore e të cilat ndërlidhen me punën e gjykatës, si dhe planeve për adresim të rekomandimeve nga KGJK.
- XXXIII. Hartimi i raporteve për numrin e seancave të mbajtura, seancave të shtyera dhe seancave të anuluara.
- XXXIV. Hartimi i raporteve periodike dhe vjetore të punës së kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarëve mbikëqyrës të degëve sipas formatit të përcaktuar me aktet e KGJK-së.
- XXXV. Ndihma Juridike Ndërkombëtare
- XXXVI. Caktimi i shqyrtimeve gjyqësore dhe publikimi i orarit të mbajtjes së tyre
- XXXVII. Orari i Punës dhe Respektimi i Kodit të Mirësjelljes
- XXXVIII. Trupi për Menaxhimin e Krizave
- XXXIX. Transparenca dhe llogaridhënia
- XL. Administrata Gjyqësore
- XLI. Synimet e përcaktuar nga ana e gjykatës
- XLII. Ndryshimi eventual i këtij plani
- XLIII. Zbatimi

OBJEKTIVI I MENAXHMENTIT TË KËSAJ GJYKATE

Ndër objektivat kryesore për vitin 2025 në mes tjera janë përfundimi i proceseve gjyqësore në kohë sa më të arsyeshme në të gjitha departamentet dhe divisionet ashtu siç parashihet me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, po ashtu edhe në pajtueshmëri të plotë me standardet e tjera ndërkombëtare dhe ligjet në fuqi, në atë mënyrë që gjatë vitit 2025 në këtë gjykatë të caktohen lëndët e pranuara gjatë vitit 2023 dhe 2024 në të gjitha lëmit. Po ashtu objektiv tjetër i rëndësishëm është që të vazhdohet me veprime konkrete që gjatë vitit 2025 të kihet parasysh si gjatë vitit 2024, që ngarkesa me lëndë e gjyqtarëve të departamenteve të njëjta të jetë e barabartë si në qendër ashtu edhe në degët e kësaj gjykatë, por nësë departamentet e caktuara nuk janë të ngarkuar, atëherë ata gjyqtarë të angazhohen në departamete, divizione apo degë të gjykatës me qëllim të rritjes së transparencës.

Objektiva tjera të rëndësishëm janë edhe rritja e besimit të publikut, llogaridhënia e gjyqtarëve dhe gjithë stafit tjetër të kësaj gjykatë, përmirësimi i ofrimit të shërbimeve të gjykatës ndaj qytetarëve si në aspektin e infrastrukturës, ndihmën e ofruar publikut përmes teknologjisë së informacionit të avancuar, digjitalizimi i sistemit për menaxhimin e lëndëve si dhe ofrimin e informatave të ndryshme duke përfshirë edhe numrin e publikimit të vendimeve gjyqësore me qëllim që të bëhet sa më e lehtë qasja në drejtësi për qytetarët.

Përmes këtij plani përcaktohen prioritetet e vitit 2025 të kësaj gjykatë, të cilat konsistonë në zbatimin dhe respektimin e planeve strategjike të nxjerra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për zgjidhjen sa me efikase të lëndëve, komunikimit me media si dhe marrëdhëniet me akterët e tjerë, organizimin e punës së gjykatës dhe administratës gjyqësore duke mbështetur degët e kësaj gjykatë me gjyqtar dhe staf tjetër mbështetës aty ku ka nevojë, ngritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënieg nga stafi administrativ dhe gjyqësor si dhe zbatimin në tërësi të projektit të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve SMIL.

Qëllimi kryesor i këtij plani të punës është të trajtoj në mënyrë specifike çështjen e efikasitetit të gjykatës në kuptimin e veprimeve të cilat ndërlidhen me zgjidhjen e sa më shumë të lëndëve në të gjitha departamentet, divisionet dhe degët e kësaj gjykatë.

Venhar SALIHU,

Kryetar i Gjykatës Themelore në Gjilan

Plani dhe Programi i Punës 2025

PËRMBLEDHJE

Bazuar në nenin 13 dhe 14 të Ligjit për Gjykatat (Ligji 06/L – 054), lidhur me nenin 10, të Rregullores numër 17/2024 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, pas marrjes së propozimeve në mbledhjen e Kolegjiumit të gjyqtarëve të kësaj gjykate të datës 05.12.2024 si dhe takimeve në degët e gjykatës edhe atë në Viti, me datë 10.12.2024, Kamenicë me datë 09.12.2024 dhe Novëbërdë me datë 06.12.2024, përcakton Planin e Punës dhe Programin për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve, të gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Themelore në Gjilan për vitin 2025.

Plani i punës dhe programi për zgjidhjen efikase të lëndëve për vitin 2025 është strukturuar në atë mënyrë që të avancoj aktivitetet dhe rezultatet në punë me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të Gjykatës Themelore në Gjilan, si në aspektin e organizimit profesional ashtu edhe në atë administrativo teknik, realizimi i të cilave do të bëhet përmes aktiviteteve të arritshme brenda periudhës një vjeçare.

Ky plan program paraqet tërësinë e aktiviteteve që do të zbatohen në vitin 2025 ndër të tjera përcakton organizimin e punës në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Qëllimi i planit të punës të kësaj gjykate është të trajtoj në mënyrë specifike çështjen e efikasitetit të gjykatës në kuptimin e veprimeve të cilat ndërlidhen me zgjidhjen e numrit të lëndëve, të trajtohen lëndët me prioritet ligjor (si në fushën penale ashtu edhe në atë civile), të trajtohen lëndët e kthyera në rigjykim, të i jepet përparësi lëndëve të korruptionit dhe krimtit të organizuar, me fjalë të tjera të veprohet komfor Planit Strategjik për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve të Korruptionit dhe Krimtit të Organizuar 2022 – 2025 dhe Planin Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 – 2025.

Ky plan është votuar nga të gjithë gjyqtarët që kanë qenë prezent në takimin e datës 30.12.2024.

Plani dhe Programi i Punës 2025

I. Përcaktimi i numrit të gjyqtarëve brenda departamenteve dhe divizioneve, proporcional me numrin e lëndëve të cilat janë të pa trajtuara brenda gjykatë

Me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Themelore në Gjilan, udhëheqë kryetari i gjykatës ndërsa në mungesë të kryetarit me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës udhëheq nën kryetari i gjykatës Rilind Sermashaj.

Për organizimin e punës së degës së kësaj gjykate në Kamenicë udhëheq – gjyqtarja mbikëqyrëse Valbonë Dërvodelli, për organizimin e punës së degës së kësaj gjykate në Viti udhëheq gjyqtari mbikëqyrës Alush Sinani ndërsa për organizimin e punës së degës së kësaj gjykate në Novobërdë udhëheq gjyqtari mbikëqyrës Gazmend Ajvazi.

Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimit të objekteve të Gjykatës Themelore në Gjilan do të udhëheq U.D administratori i Gjykatës Themelore në Gjilan, Sylejmon Qarrolli, së bashku me shefen e ZQML-së Valbona Dulahu dhe shefen ZSHP-së Linda Salihu.

Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimit të objekteve për degën e kësaj gjykate në Kamenicë do të udhëheq ndihmës administratorja Lulavere Basha.

Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimit të objekteve për degën e kësaj gjykate në Viti do të udhëheq ndihmës administratori Fahredin Hoxha.

Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimit të objekteve për degën e kësaj gjykate në Novobërdë do të udhëheq ndihmës administratori Synaj Qerimi.

Për kryerjen e funksioneve gjyqësore të Gjykatës Themelore në Gjilan janë organizuar tri (3) Departamente:

- 1) Departamenti për Krime të Rënda,
- 2) Departamenti për të Mitur dhe
- 3) Departamenti i Përgjithshëm, në kuadër të së cilët funksionojnë:
- 4) Divizioni Penal
- 5) Divizioni Civil dhe

Plani dhe Programi i Punës 2025

6) Divizioni për Kundërvajtje

Aktualisht në Gjykatën Themelore në Gjilan duke përfshirë edhe degët e saj do të punojnë tridhjetëedy (32) gjyqtarë, ku të gjithë gjyqtarët janë të sistemuar në departamente, degë dhe divizione ndërsa katër (4) gjyqtarë gjatë gjashtë mësuarit të parë të vitit 2025 do të arrin moshën e pensionimit, kurse një gjyqtare në fillim të muajit Janar, shkon në pushim të lehonisë.

Për udhëheqës të departamenteve dhe gjyqtar përgjegjës të divizioneve caktohen:

- 1) Agim Ademi – Udhëheqës i Departamentit për Krime të Rënda;
- 2) Sahit Boroci - Udhëheqës i Departamenti për të Mitur;
- 3) Mevlide Shabani - Udhëheqës i Departamentit të Përgjithshëm;
- 4) Bekim Salihu – Udhëheqës i Divisionit Civil;
- 5) Behar Ymeri - Udhëheqës i Divisionit Penal;
- 6) Luljeta Shabani – Udhëheqës i Divisionit për Kundërvajtje.

Udhëheqësit e Departamenteve dhe përgjegjësit e Divisionit, do ti raportojnë kryetarit të gjykatës për punën e Departamenteve - Divisionit, së paku njëherë në tre (3) muaj. Pjesë e raporteve të udhëheqësit të departamentit dhe përgjegjësit të divisionit, duhet të jenë edhe raportet e gjyqtarëve përgjegjës të divizioneve.

Në Departamentin për Krime të Rënda do të punojnë gjyqtarët:

Departamenti për Krime të Rënda

- Agim Ademi
- Rilind Sermashaj
- Naser Maliqi
- Sabedin Mushica
- Islam Thaqi (pensionohet në muajin Prill të vitit 2025)
- Sahit Borovci dhe
- Valbonë Dërvodelli

Plani dhe Programi i Punës 2025

Me qëllim të zgjidhjes më efikase të lëndëve gjyqtarët e Departamentit të Krimeve të Rënda do të angazhohen edhe në zgjidhje e lëndëve nga departamentet tjera dhe në degët e kësaj gjykate, varësisht nga nevojat të cilat do të paraqiten gjatë vitit 2025.

Sa përket këtij departamenti, gjyqtarët Sahit Borovci dhe Valbona Dërvodeli, nuk do të ngarkohen më lëndë të këtij departamenti, por vetëm do të marrin pjesë në trupe gjykuese.

Me qëllim të efikasitetit të kësaj gjykate gjyqtarët Islam Thaqi, Agim Ademi, Naser Malqi, Sabedin Mushica, Rilind Sermaxhaj do të vazhdojnë të gjykojë lëndët e divisionit penal/departamentit të përgjithshëm të kësaj gjykate dhe degës në Viti me të cilat tanimë janë ngarkuar me vendime përkatëse gjatë vitit 2023 dhe 2024.

Sa i përket gjyqtarit Islam Thaqi, i njëjtë gjatë vitit 2025 nuk do të ngarkohet më lëndë të reja, por do të vazhdoj të punoj lëndë të cilat tashmë është i ngarkuar, pasi që i njëjtë siç svaruan më lartë do të pensionohet.

Gjyqtarët e DKR-së, të cekur më lartë, mundë të gjykojnë edhe në procedurë paraprake në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal.

Në Departamentin për Mitur do të punojnë gjyqtarët:

Departamenti për të Mitur

- Sahit Boroci
- Behar Ymeri

Në Departamentin për të Mitur do të punoj gjyqtari për të mitur Sahit Boroci i cili edhe është përgjegjës i këtij departamenti, e në rast pushimi, sëmundje apo raste kur ai nuk mundet të veproj, lëndët si zëvendës i tij do të jetë gjyqtari Behar Ymeri, ku me qëllim të efikasitetit, gjyqtarit Behar gjatë vitit 2025 do ti ndahen në punë lëndë nga ky departament për ti gjykuar.

Plani dhe Programi i Punës 2025

Me qëllim të efikasitetit të kësaj gjykate gjyqtari Sahit Borovci do të vazhdojë të gjykojë lëndët e departamentit për të mitur dhe ato të divizionit penal të kësaj të kësaj gjykate me të cilat tanimë është ngarkuar me vendim gjatë vitit 2024, por, mund të ngarkohet edhe me lëndë të tjera, i njëjtë nuk do të ngarkohet me lëndë nga departamenti për Krime të Rënda, me përjashtim kur gjyqtarët e tjerë të këtij departamenti për arsyen procedurale nuk mund të procedojnë tutje.

Në Divisionin Penal do të punojnë gjyqtarët:

- Behar Ymeri
- Veli Kryeziu dhe
- Mevlide Shabani

Divizioni Penal

Me qëllim të efikasitetit të kësaj gjykate gjyqtari Behar Ymeri, përveq lëndëve të këtij departamenti do të vazhdojë të gjykojë lëndët e divizionit penal pranë degës së kësaj gjykate në Viti me të cilat tanimë është ngarkuar gjatë vitit 2023 dhe 2024.

Me qëllim të efikasitetit të kësaj gjykate gjyqtari Veli Kryeziu, përveq lëndëve të kësaj gjykate në këtë departament, do të vazhdojë të gjykojë lëndët e divizionit kundërvajtës pranë degës së kësaj gjykate në Viti me të cilat tanimë është ngarkuar gjatë vitit 2023 dhe 2024, por i njëjti nuk do të ngarkohet me lëndë të reja, pasi që në pjesë e dytë të vitit 2025 i njëjti pensionohet.

Me qëllim të efikasitetit të kësaj gjykate gjyqtarja Mevlide Shabani përveq lëndëve në këtë departament të kësaj gjykate do të vazhdojë të gjykojë lëndët e divizionit civil pranë kësaj gjykate me të cilat tanimë është ngarkuar gjatë vitit 2024 dhe mundë të ngarkohet edhe me lëndë të tjera.

Me qëllim të zgjidhjes më efikase të lëndëve gjyqtarët e Departamentit i Përgjithshëm/Divizioni Penal, sipas nevojës mund të ngarkohen dhe gjykojnë lëndë nga departamentet tjera dhe në degët e kësaj gjykate, varësisht nga nevojat të cilat do të paraqiten gjatë vitit 2025.

Në Divisionin Civil do të punojnë gjyqtarët:

- Berat Spahiu
- Mirvete Alidemi
- Florije Qerimi
- Kaltrinë Haliti
- Liridona Haziri - Mustafa
- Erlinda Elezi Tosku
- Bekim Salihu
- Arben Xheladini dhe
- Edona Zuzaki

Divizioni
Civil

Lëndët civile kontestimore dhe lëndët përmbarimore (CP dhe CPK) të këtij divizioni do t'i u ndahen në punë të gjithë gjyqtarëve të këtij divizioni, përvèç gjyqtarës Edona Zuzaki dhe sipas nevojës do të ngarkohet edhe kryetari i kësaj gjykate.

Gjyqtarët Kaltrina Haliti, Bekim Salihu për veç lëndëve të këtij divizioni do të vazhdojnë të gjykojnë edhe lëndët civile-kontestimore të kësaj dege në Kamenicë me të cilat lëndë janë ngakruar me vendime gjatë vitit 2024, kurse lëndët e gjyqtarës Gentiana Shabani të kësaj dege do të analizohen se sa nuk janë përfunduar dhe me vendime të veganta të dë ngarkohen gjyqtarët të tjera.

Sa i përket gjyqtare Edona Zuzaki, e njejtë gjatë vitit 2025 do ti gjykojë lëndët nga kontratat kolektive të cilat kanë ardhur në gjykatë deri në fund të vitit 2024, e për të cilat nuk ka qenë e mundur të përfundohen jashtë seance dhe eventualisht të kësaj natyre do të ngarkohet edhe me lëndët të cilët arrijnë edhe gjatë vitit 2025, kurse do të ngarkohet edhe me lëndë të tjera civile kontestimore në degën e kësaj gjykate në Viti përmes vendimit të veçantë.

Këtij divizioni edhe gjatë vitit 2025 do ti ndimojnë gjyqtarët Mevlide Shabani dhe Gazmend Ajvazi, si dhe gjyqtarë të tjera nga departamentet të tjera, por edhe gjyqtarët në këtë divizion mundë të ngarkohet me lëndë të divizioneve të tjera dhe me lëndë të degëve të kësaj gjykate, por për këtë do të vendoset me vendime të veganta sipas nevojave të gjykatës.

Në Divisionin e Kundërvajtjes do të punojnë gjyqtarët:

- Menderes Behluli dhe
- Luljetë Shabani

Divizioni Kundërvajtjes

Në Divisionin e Kundërvajtjes të kësaj gjykate do të punojnë gjyqtari Menderes Behluli dhe gjyqtarja Luljetë Shabani mirëpo mund të ketë ndryshime në këtë divizion për faktin se gjyqtari Menderes Behluli gjatë vitit 2025 do ta arrijë moshën e pensionimit dhe me lëndët e të njëjtë gjyqtarë mundë të ngarkohet ndonjë gjyqtar nga qendra apo degët e kësaj gjykate.

Gjyqtari Menderes Behluli, gjatë vitit 2025 nuk do të pranojë lëndë të degës së Vitisë.

Degët e Gjykatës

Degët e Gjykatës Themelore në Gjilan janë në: Kamenicë, Viti dhe Novobërdë të cilat funksionin gjyqësor e kryejnë përmes Departamentit të Përgjithshëm ndërsa secila degë e Gjykatës e ka gjyqtarin mbikëqyrës i cili është përgjegjës për punën e degës.

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë

Me qëllim të ndarjes së çështjeve sipas natyrës së tyre në Gjykatën Themelore në Gjilan- Dega në Kamenicë do të veprojnë departamentet si në vijim:

1. Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal,
2. Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil dhe
3. Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Kundërvajtës.

Plani dhe Programi i Punës 2025

Në Divisionin Penal të kësaj dege do të punoj gjyqtari:

- Valbona Dërvodeli

Divizioni
Penal

Gjyqtarja Mbikëqyrëse Valbonë Dërvodelli, gjatë vitit 2025 do të gjykoj dhe ngarkohet me lëndët e divisionit Penal (duke përfshirë edhe procedurën paraprake) dhe të Kundërvajtes të kësaj dege dhe Degës së kësaj gjykate në Novëbërdë si dhe do ti përfundoj lëndët civile të cilët i ka në shqyrtim përgatitor dhe kryesor të kësaj dege gjithashtu e njëjtë do të angazhohet edhe në trup gjykues në Departamentin e Krimeve të rënda (një apo dy ditë në javë).

Gjyqtari Sadri Krasniqi do të përfundoj lëndët që i ka në punë, por i njëjtë nuk do të ngarkohet me lëndë të reja, për shkak se në fillim të vitit do të pensionohet, kurse me të gjitha lëndët e të njëjtit gjyqtar do të ngarkohet gjyqtarja Valbona Dërvodeli.

Sa i përket procedurës paraprake, në ato raste kur ngritet aktakuza e ka pengesa ligjore për të procesuar gjyqtarja Valbona Dërvodeli, do të përjashtohet dhe ti caktohet një gjyqtari tjetër.

Në Divisionin Civil të kësaj dege do të punojnë gjyqtarët:

- Besnik Pireva,


Divizioni
Civil

Në këtë degë për lëndë civile-kontestimore do të angazhohen edhe gjyqtarët Bekim Salihu dhe Kaltrina Haliti dhe sipas nevojës mundë të angazhohen edhe gjyqtar të tjera, kurse për lëndët civile kontestimore të cilat lëndë ka qenë e ngarkuar gjyqtarja Valbona Dërvodeli dhe nuk është

Plani dhe Programi i Punës 2025

në shqyrtim përgatitor, kryesor apo nësë ka ndërmarrë veprime të shumta, pas analizimit të statistikave do të ngarkohet ndonjëri nga gjyqtarët e transferuar, apo edhe ndonjë gjyqtar tjetër me vendim të veçantë.

Në Divisionin për Kundërvajtje të kësaj dege do të punoj gjyqtari:



Gjykata Themelore në Gjilan- Dega në Viti

Me qëllim të ndarjes së çështjeve sipas natyrës së tyre në Gjykatën Themelore në Gjilan- Dega në Viti do të veprojnë departamentet si në vijim:

1. Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal,
2. Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil dhe
3. Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Kundërvajtës.

Udhëheqës të këtyre departamenteve do tëjenë:

1. Blerina Jakupi Ramadani, udhëheqëse e divisionit penal dhe kundërvajtës,
2. Raif Fazliu, udhëheqës i divisionit civil.

Në Divisionin Penal të kësaj dege do të punojnë gjyqtarët:

- Blerina Jakupi Ramadani dhe
- Alush Sinani

Divizioni
Penal

Gjyqtari-mbikqyrësi i degës Alush Sinani ngarkohet me lëndë të procedurës paraprake, me lëndë të Divisionit Kundërvajtës të kësaj dege dhe sipas nevojës do të ngarkohet edhe me lëndë të kundërvatjes edhe në qendër (Gjilan), por i njëjti do të vazhdoj të përfundoj lëndët civile kontestimore të cilat i ka në punë në seancën përgatitore apo kryesore dhe lëndët civile kontestimore të ardhura në gjykatë deri në vitin 2021 me të cilat është i ngarkuar.

Gjyqtari Arben Xheladini, gjatë vitit 2025, do ti përfundoj edhe lëndët në Divisionin Penal, ku është ngarkuar në vitin 2024.

Në Divisionin Civil të kësaj dege do të punojnë gjyqtarët:

- Raif Fazliu
- Nexhat Aliu
- Qendresa Sejdiu.

Divizioni
Civil

Gjyqtari Arben Xheladini do të vazhdoj që ti përfundoj lëndët civile-kontestimore në këtë degë deri sa ti përfundojë të gjitha lëndët me të cilat është i ngarkuar në këtë divizion.

Plani dhe Programi i Punës 2025

Lëndët civile-kontestimore të vitit 2022, 2023 dhe 2024, me të cilat është i ngarkuar gjyqtari Alush Sinani dhe nuk është në shqyrtim përgatitor,kryesor apo nuk ka ndërmarrë veprime të shumta, do të ngarkohet gjyqtarja Edona Zuzaki, dhe sipas nevoj edhe gjyqtarë të tjera nga qendra, me qëllim që ngarkesa e gjyqtarëve të jetë e njëjtë.

Në Divisionin për Kundërvajtje të kësaj dege do të punojnë gjyqtarët:

- Alush Sinani

Divizioni
Kundërvajtës

Gjyqtarja Blerina Jakupi-Ramadani do të lirohet nga lëndët të Kundërvatjes të pranuara deri në fund të vitit 2024, ku do ti dorëzojë gjyqtarit Alush Sinani dhe nuk do të ngarkohet gjatë vitit 2025.

Gjyqtarët nga qendra do të vazhdojnë ti gjykojnë lëndët e kundërvatjes në këtë degë që i kanë në punë dhe janë ngarkuar gjatë vitit 2023 dhe 2024, por varësisht nga numri lëndëve mund të barten tek gjyqtari Alush Sinani.

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega Novobërdë

Me qëllim të ndarjes së çështjeve sipas natyrës së tyre në Gjykatën Themelore në Gjilan- Dega në Novobërdë do të veprojnë departamentet si në vijim:

1. Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal,
2. Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil dhe
3. Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Kundërvajtës.

Plani dhe Programi i Punës 2025

Në Divisionin Civil të kësaj dege do të punojnë gjyqtarët:

- Gazmend Ajvazi

Divizioni
Civil

Gjyqtari Gëzimend Ajvazi, njëherit mbikëqyrës i kësaj dege përveç lëndëve civile në këtë degë do të vazhdojë ti gjykojë edhe lëndët civile-kontestimore të cilat i ka në punë në qendër kurse sa i përket lëndëve me të cilat është i ngarkuar gjyqtarit Boban Aleksiq do të ngarkohet mbikëqyrësi i degës Gazmend Ajvazi dhe sipas nevojës mund të angazhohet edhe ndonjë gjyqtar tjetër nga qendra.

Sa i përket gjyqtarit Boban Aleksiq i cili ka qenë i angazhuar në këtë degë, me Vendimin e KGJK-së, i njëjtë është avancuar në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Në Divisionin Penal dhe Kundërvajtës të kësaj dege do të punoj gjyqtarja:

- Valbona Dërvodeli

Divizioni Penal
dhe kundërvajtës

Sa i përket procedurës paraprake edhe gjatë vitit 2025 do të vazhdojti gjykoj kryetari i kësaj gjykatës Venhar Salihu.

Plani dhe Programi i Punës 2025

Sa i përket gjyqtarëve Dibran Jusufi dhe Freskim Musliu të cilët është vendosur nga KGJK-ja që të transferohen në gjykatën tonë nga muaji shkurt përkatësisht muaji mars i vitit 2025, të njejtë do të angazhohen në degët e kësaj gjykate apo edhe në qendër varësisht nga nevojat e gjykatës.

II. Përcaktimi i numrit të bashkëpunëtorëve brenda departamenteve dhe divizione proporcional me numrin e lëndëve të cilat janë të pa trajtuar brenda gjykatës.

Në gjykatën tonë së bashku me degët e saja si bashkëpunëtor profesional janë të pranuar 23 bashkëpunëtorë profesional (ku 3 bashkëpunëtore profesionale gjatë këtij viti gjenden në pushim të lehonisë).

Në Gjykatën Themelore në Gjilan do të punojnë 14 (katërmëdhjetë) bashkëpunëtor profesional, në degën e kësaj gjykate në Viti do të punojnë 3 (tre), në degën e kësaj gjykate në Kamenicë do të punojnë 2 (dy) ndërsa në degën e kësaj gjykate në Novobërdë do të punoj 1 (një) bashkëpunëtor profesional.

Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil do të angazhohen 8 (shtatë) bashkëpunëtorë profesional.

Në Departamentin për Krime të Rënda, në Departamentin për të Mitur dhe Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, do të angazhohen 6 (shtatë) bashkëpunëtorë profesional.

Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni për Kundërvajtje, do të angazhohet 1 (një) bashkëpunëtor profesional.

Në degën e kësaj gjykate në Viti do të angazhohen 3 (tre) bashkëpunëtor profesional, në degën e kësaj gjykate në Kamenicë do të angazhohen 2 (dy) bashkëpunëtor profesionale, ndërsa në degën e kësaj gjykate në Novobërdë do të angazhohet 1 (një) bashkëpunëtor profesional.

III. Përcaktimi i objektivave dhe përgjegjësive të të punësuarve brenda administratës së gjykatës, për të sigruar efikasitet në punë.

Në Gjykatën Themelore në Gjilan kemi të angazhuar staf administrativ të mjaftueshëm përveç që kemi mungesë të zyrtareve ligjore. Sa i përket përgjegjësive të këtij stafi tani e një kohë të

gjithë të punësuarit respektojnë orarin, vendin dhe detyrat e punës dhe në këtë mënyrë është siguruar efikasiteti i administratës gjyqësore në punës.

Edhe gjatë vitit 2025 ndër objektivat kryesore mbetet që stafi administrativ të mbahet përgjegjës lidhur me detyrat e tyre të punës, të respektohet kodi i sjelljes, të respektohet orari, detyrat dhe vendi i punës.

IV. Përcaktimi i kalendarit vjetor të mbledhjeve të kolegjiumit të gjyqtarëve të gjykatës dhe kolegjiumit të gjyqtarëve të Degës

Mbledhjet e kolegjiumit të gjithë gjyqtarëve do të mbahen konform edhe Rregullores për Organizimin dhe Veprimtarin e Brendshme të Gjykatave, edhe atë: Mbledhjet e kolegjiumit të gjyqtarëve do të mbahen sipas nevojës dhe jo më pak se 1 mbledhje brenda 3 muajve e gjithashtu mbledhje të vazhdueshme do të mbahen me shefat e departamenteve dhe mbikëqyrësve të degëve. Do të ketë edhe mbledhje me u.d administratorin, ndihmës administratorët dhe shefat përkatës të administratës së kësaj gjykate dhe degëve të saj gjithnjë me qëllim të identifikimit dhe adresimit të problemeve.

Kryetari i Gjykatës sa herë që e sheh të nevojshme për të diskutuar dhe vendosur për çështje të caktuara mund të mund të mbajë takim formal dhe jo formal me gjyqtarët.

Udhëheqësit e departamenteve së paku çdo tre muaj do mbajnë mbledhje me gjyqtarët e departamentit përkatës.

Në kolegjumin vjetor bëhet shqyrtimi i punës dhe funksionimit të gjykatës gjate vitit të kaluar po ashtu caktimi i gjyqtareve në departamente dhe divizione të gjykatës, përbërja dhe menaxhimi i kolegjeve për t'i gjykuar çështjet që kërkojnë trup gjykues, plani vjetor i punës së gjykatës për vitin e ardhshëm, dhe çështje tjera të përcaktuara nga kryetari i gjykatës në konsultim me gjyqtarët.

Kryetari i gjykatës thërret kolegjumin e gjyqtarëve në gjykatë për të diskutuar lidhur me administrimin e gjykatës, për të shqyrtuar organizimin e punës, rezultatet e arritura në gjykatë dhe për t'i trajtuar problemet dhe sfidat e punës.

Plani dhe Programi i Punës 2025

Pjesëmarrja në kolegjiume dhe mbledhjet e departamenteve dhe divizione është e obligueshme.

Kolegjumi i gjyqtarëve në mbledhjet e tij nxjerr edhe rekomandime të cilat duhet të përfillen nga kryetari i gjykatës, nënkryetari, gjyqtarët mbikëqyrës, gjyqtarët, dhe stafi administrativ. Rendi i ditës për mbledhjen e kolegjumit të gjyqtarëve përcaktohet nga kryetari i gjykatës.

U.D i administratorit mbështet kryetarin e gjykatës në organizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të kolegjumit të gjyqtareve, furnizon gjyqtarët me materialet e rëndësishme të mbledhjes dhe mban procesverbalin përrnjedhën e mbledhjes, të cilat procesverbale u dorëzohen gjyqtarëve të gjykatës, për të paraqitur vërejtjet e tyre eventuale, pastaj miratohen në kolegjumin e radhës. Të gjitha dokumentet e takimeve të kolegjumit të gjykatës duhet të arkivohen në dosje të veçanta.

V. Përaktimi i kalendarit vjetor të takimeve të rregullta me bashkpuntorët profesional dhe administratën.

Në kuadër të përbushjes së misionit dhe objektivave të Gjykatës Themelore në Gjilan për vitin 2025, është planifikuar mbajtja e takimeve të rregullta si me bashkëpunëtorët profesional ashtu edhe me stafin administrativ të gjykatës.

Takimet me Bashkëpunëtorët Profesional: Kryetari, nënkryetari ose U.d i administratorit të gjykatës do të organizojnë takime të rregullta me bashkëpunëtorët profesional të gjykatës, të paktën një herë në çdo tre muaj. Këto takime do të shërbejnë për të diskutuar mbi progresin e punës dhe për të koordinuar angazhimet që synojnë zvogëlimin e numrit të lëndëve në gjykatë.

Takimet me Stafin Administrativ: Takimet me stafin administrativ do të mbahen çdo muaj dhe do të udhëhiqen nga administratori dhe zëvendës-administratori i gjykatës. Qëllimi kryesor i këtyre takimeve është koordinimi i detyrave administrative, zgjidhja e sfidave të brendshme dhe sigurimi i funksionimit efikas të administratës gjyqësore, shërbimin e ofruar tek qytetarët dhe përfaqësuesit e tyre, transparencën, llogaridhëni, respektimin e orarit, detyrave dhe vendit të punës etj.

Plani dhe Programi i Punës 2025

VI. Krijimi i trupave brenda gjykatës dhe Degës për të siguruar skanim të hershëm të parashtresave të pranuara në gjykatë.

Në kuadër të objektivave për vitin 2025, Gjykata Themelore në Gjilan edhe këtë vit, ka planifikuar krijimin e një mekanizmi të brendshëm për sigurimin e skanimit të hershëm të parashtresave, si dhe kryerjen e veprimeve teknike të ndërlidhura me lëndët. Për këtë qëllim, me rotacion, do të caktohet së paku një bashkëpunëtor profesional, i cili do të angazhohet për të kryer këto detyra specifike. Caktimi i bashkëpunëtorëve do të bëhet çdo tre muaj, bazuar në një sistem përzgjedhjeje të përcaktuar nga Kryetari i Gjykatës, duke siguruar përfshirjen e të gjithë bashkëpunëtorëve profesional në këtë proces.

VII. Zbatimi i Programit SMIL për regjistrimin e lëndëve, caktimin e seancave, vendosjen e akteve procedurale si dhe akteve finale, duke siguruar kualitet të të dhënave respektivisht përputhje të plotë të dosjes fizike me dosjen elektronike, dhe atë nga faza e pranimit të lëndës, trajtimit e deri te arkivimi.

Gjykata Themelore në Gjilan është e përkushtuar për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të Programit SMIL, duke siguruar që çdo proces administrativ dhe gjyqësor të regjistrohet dhe të menaxhohet në përputhje me standardet më të larta të efikasitetit dhe cilësisë. I gjithë stafin i gjykatës, duke përfshirë gjyqtarët, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjorë, stafin administrativ dhe personelin tjetër mbështetës, do të angazhohet në përdorimin rigoroz të këtij sistemi për: regjistrimin e lëndëve, caktimin e seancave dhe vendosjen e akteve procedurale dhe finale. Për të garantuar implementimin efikas të Programit SMIL, stafi i gjykatës do t'u nënshtronet trajnimeve të rregullta, të eilat do të përqendrohen në profesionalizimin e mëtejshëm të aftësive të tyre për përdorimin e sistemit dhe përmirësimin e qasjes ndaj menaxhimit të të dhënave. Këto trajnime synojnë jo vetëm përforcimin e kompetencave teknike, por edhe krijimin e një kulture institucionale të orientuar drejt modernizimit dhe dixhitalizimit të shërbimeve gjyqësore.

VIII. Zbatimi i Sistemit të Evidencës Penale, duke siguruar vendosje të drejtë brenda afateve, në pajtim të plotë me aktin gjyqësor.

Plani dhe Programi i Punës 2025

Në Gjykatën Themelore në Gjilan të gjitha të dhënat penale janë futur brenda afatit dhe procedurave ligjore me ndonjë përjashtim për shkak të gabimeve teknike dhe se certifikatat mbi të kaluarën penale të personave lëshohen duke u bazuar në këtë sistem.

IX. Kalendar i mbajtjes së seancave efektive (bllok) për të trajtuar lëndët me efikasitet,

Në Gjykatën Themelore në Gjilan, seancat gjyqësore do të caktohen në ditët e planifikuara të punës nga gjyqtarët e departamenteve përkatëse, duke siguruar trajtimin efikas dhe të koordinuar të lëndëve në punë përkundër që një praktikë e tillë edhe më parë është zbatuar në gjykatën tonë.

X. Evitimi i shtyerjes dhe anulimit të seancave, duke siguruar që seancat e planifikuara të mbahen në salla të gjykimeve.

Në Gjykatën Themelore në Gjilan të gjitha seancat e planifikuara do të mbahen në sallat e gjykimeve, duke respektuar procesin e rregullt të destinuar për to. Përjashtimisht, vetëm në raste kur mungesa e kushteve nuk lejon mbajtjen e të njëjtave, do të shqyrtohen alternativa të tjera që ndikojnë në caktimin sa më të shpejtë të tyre, duke synuar gjithmonë shhangjen e shtyrjes apo anulimit të seancave, për veç në ato raste kur nuk ka mundësi që të mbahet dhe rastevë kur ligjet pozitive e kanë paraparë që të shtyhen.

XI. Zbatimi i programit për audio dhe video inçizim të seancave në sallat e gjykimit në fushën penale

Në Gjykatën Themelore në Gjilan, në përputhje me mundësitë dhe kushtet e krijuara, do të zbatohet programi për audio dhe video inçizimin e seancave gjyqësore.

XII. Publikimi i akteve gjyqësore meritore, e të cilat nuk kanë kufizime për publikim

Një nga objektivat kryesore të Gjykatës Themelore në Gjilan është rritja e transparencës përmes publikimit të një numri sa më të madh të vendimeve meritore, të cilat nuk kanë kufizime për publikim. Publikimi i këtyre vendimeve ka një rëndësi të veçantë, pasi kontribuon në informimin e publikut, ndihmon në forcimin e besimit në sistemin gjyqësor dhe shërben si një burim i rëndësishëm për studime juridike dhe praktikën e mirë ligjore. Duke ndjekur praktikat e mira të

vitit 2023 dhe 2024, në vitin 2025, gjykata jonë synon të dyfishojë numrin e vendimeve gjyqësore të publikuara. Kjo përpjekje do të përfshijë standardizimin e procesit të publikimit, përmirësimin e qasjes së publikut ndaj dokumenteve gjyqësore dhe respektimin e plotë të rregullave që mbrojnë të dhënat personale dhe konfidencialitetin.

XIII. Respektimi i afateve për dërgimin e lëndëve në gjykatën e shkallës së dytë dhe tretë.

Gjatë vitit 2025, synohet që brenda afatit ligjore të gjitha lëndët e Gjykatës Themelore në Gjilan e të cilat janë të ankimuara të dërgohen në gjykatën e shkallës së dytë dhe të tretë brenda afateve të parapara ligjore.

XIV. Ekzekutimi me kohë i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, përfshirë edhe vendimet gjyqësore nga lëmia e kundërvajtjeve

Në Gjykatën Themelore në Gjilan lidhur me ekzekutimin e vendime gjyqësore të formës së prerë përshifrë edhe ato të lëmisë kundërvajtëse synohet që përkundër angazhimit të madhe edhe gjatë vitit 2025 në këtë sektor të rriten kapacitetet dhe ekzekutimi i vendime të formës së prerë të kryhet brenda një kohe sa më të shkurtër duke respektuar afatet ligjore të parapërcaktuara.

XV. Zbatimi i planit të trajnimeve nga bashkëpunëtorët dhe administrata

Sa i përket Gjykatës Themelore në Gjilan së bashku me degët e saja, të gjitha kërkesa për vijimin e trajnimeve që kanë të bëjnë me bashkëpunëtorët profesional dhe administratën do të analizohen dhe më pas gjatë vitit 2025 do të vijohen sidomos tek trajnimet e rëndësishme për bashkëpunëtorët profesional dhe administratën gjyqësore.

XVI. Vlerësimi i përformancës së punës së bashkëpunëtorëve

Në Gjykatën Themelore në Gjilan kemi pranuar formularët e rinj për vlerësimin e përformancës së punës së bashkëpunëtorëve profesional, të njejtë janë duke raportuar në bazë të këtyre formularëve dhe gjatë vitit 2025 do të bëhet vlerësimi i përformancës së punës së bashkëpunëtorëve profesional në bazë të formularëve të rinj.

XVII. Vlerësimi i përformancës së punës së zyrtarëve të administratës.

Në Gjykatën Themelore në Gjilan vlerësimi i përformancës së punës së zyrtarëve të administratës siç parashihet në dispozitat ligjore do të bëhet nga mbikëqyrësit e drejpërdrejtë të tyre.

XVIII. Zbatimi i rekomandimeve ZKA si dhe planit për adresimin e rekomandimeve të SKGJK-së, për menaxhimin e pasurisë, vlerësimin e përformancës, inventarizimit, zhvlerësimit dhe asgjësimit të pasurisë.

Gjykata Themelore në Gjilan do të zbatojë rekomandimet e ZKA-së dhe planin për adresimin e rekomandimeve të SKGJK-së për menaxhimin e pasurisë, vlerësimin e përformancës, inventarizimin, zhvlerësimin dhe asgjësimin e pasurisë. Kjo do të mundësojë një menaxhim më efikas dhe transparent të burimeve të gjykatës, duke siguruar përdorimin e qëndrueshëm të pasurisë shtetërore. Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të kontribojnë në përmirësimin e kapacitetave administrative të gjykatës dhe rritjen e efikasitetit dhe transparencës në proceset e menaxhimit të pasurisë.

XIX. Zbatimi i Planit Strategjik të KGJK-2022-2025, Planit Strategjik 2022-2025 për përmirësimin e Qasjes në Drejtësi, Planit strategjik për trajtimin e lëndëve kundër korruptionit, Planit strategjik për komunikim me media dhe planet tjera strategjike të miratuara nga KGJK

Në kuadër të zbatimit të Planit Strategjik të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për periudhën 2022-2025, si dhe planeve të tjera strategjike të miratuara, Gjykata Themelore në Gjilan synon të përbushë një sërë objektivash të rëndësishëm që lidhen me përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe qasjes në drejtësi. Duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara, gjykata jonë do të angazhohet për të forcuar sistemin e drejtësisë përmes uljes së vonesave në trajtimin e lëndëve, përmirësimit të cilësisë së vendimeve dhe zgjidhjes efektive të rasteve me ndjeshmëri të lartë, veçanërisht në fushën e korruptionit dhe krimit të organizuar.

Në përputhje me objektivat për transparencë dhe përgjegjshmëri, do të avancojmë edhe më tepër praktikën e publikimit të vendimeve gjyqësore meritore, duke promovuar informimin publik dhe rritjen e besimit në sistemin gjyqësor. Gjithashtu, përmes trajnimeve të vazhdueshme të stafit

Plani dhe Programi i Punës 2025

profesional dhe administrativ, të organizuara nga Akademia e Drejtësisë apo organizata të tjera vendore dhe ndërkombe, do të sigurohet ngritja e kapaciteteve për menaxhimin më të mirë të lëndëve dhe zbatimin e standardeve bashkëkohore në punën gjyqësore.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është zbatimi i strategjive përmirësimin e qasjes në drejtësi, që synojnë lehtësimin e aksesit për të gjithë qytetarët, duke përfshirë edhe kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë. Në kuadër të zbatimit sa më të drejtë dhe të duhur të këtyre planeve strategjike të implementuara nga KGJK, gjykata jonë do të hartoj planet e saja të veprimit, me të cilat do të përcaktoj aplikimin e parimeve të parapara, krijimin e praktikave sa më të mira dhe përshtatjen e tyre me praktikat ndërkombe.

XX. Zbatimi i plotë i legjisacionit për respektimin e gjuhëve zyrtare edhe me rastin e mbajtjes së seancave gjyqësore, trajtimit të lëndëve si dhe adresimit të akteve gjyqësore.

Gjykata Themelore në Gjilan është plotësish e përkushtuar në zbatimin e legjisacionit që garanton respektimin e gjuhëve zyrtare të përcaktuara në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, duke përfshirë gjuhën shqipe dhe atë serbe. Ky përkushtim përfshin mbajtjen e seancave gjyqësore në njérën nga gjuhët zyrtare ose në një gjuhë që pala e kuption, duke respektuar kështu të drejtën e palëve për të ndjekur procesin gjyqësor në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

Në praktikat e saj të përditshme, Gjykata jonë siguron që të gjitha dokumentet gjyqësore, përfshirë parashtresat, aktet procedurale dhe aktgjykimet, të përkthehen dhe të jenë të disponueshme në gjuhën e zgjedhur nga palët, si dhe në gjuhët zyrtare të Kosovës. Kjo praktikë synon të promovojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të sigurojë që askush të mos ndihet i përjashtuar nga procesi gjyqësor për shkak të barrierave gjuhësore.

Në përputhje me këtë objektiv, gjyqtarët dhe stafi administrativ do të kenë mbështetje nga zyrtarët e përkthimit dhe të interpretimit, për të garantuar që çdo seancë dhe trajtim i lëndëve të zhvillohet në mënyrë të qartë, profesionale dhe të kuptueshme për të gjitha palët e përfshira.

XXI. Zbatimi i akteve të KGJK-së, lidhur me organizmin e brendshëm dhe menaxhimin e punës së gjykatave, përformancën e gjykatave, si dhe normën e punës së gjyqtarëve.

Gjykata Themelore në Gjilan në përbushje të objektivave të saj për vitin 2025, do të zbatojë në mënyrë të detajuar aktet normative të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), duke përfshirë Rregulloren Nr. 17/2024 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës. Një ndër prioritetet kryesore edhe këtë vit do të jetë vlerësimi dhe zbatimi i normës së punës për gjyqtarët, që përfshin numrin e lëndëve të përfunduara në përputhje me standardet e përcaktuara nga KGJK. Gjatë vitit 2025, kryetari i gjykatës do të angazhohet në mbikëqyrje të shtuar dhe analizë të rregullt të raporteve të punës së gjyqtarëve. Kjo mbikëqyrje do të fokusohet në matjen e normës së arritur dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme përmes identifikimit të sfidave dhe ofrimit të zgjidhjeve konkrete për përshtypjen e trajtimit të lëndëve.

XXII. Plani për drejtësi procedurale në gjykata

Gjykata Themelore në Gjilan gjatë vitit 2025 do të angazhohet në zbatimin e Plani për Drejtësi Procedurale në përputhje me standardet dhe praktikat e përcaktuara nga KGJK. Plani për Drejtësi Procedurale synon të rrisë efikasitetin dhe cilësinë e procesit gjyqësor, duke përmirësuar procedurat dhe praktikat e punës në mënyrë që të sigurohet qasje e drejtë dhe e barabartë në drejtësi.

Gjykata Themelore në Gjilan do të angazhohet në mbikëqyrjen e vazhdueshme të procedurave gjyqësore, duke zbatuar rekomandimet e dala nga Plani për Drejtësi Procedurale. Kjo do të përfshijë rishikimin dhe përmirësimin e rregullave procedurale për të siguruar se çështjet trajtohen në kohën e duhur dhe me efikasitet, duke respektuar të gjitha standardet e përcaktuara nga ligji dhe aktet normative të KGJK-së.

Gjykata Themelore në Gjilan do të përqendrohet në identifikimin e sfidave dhe zbatimin e përmirësimeve të nevojshme për të siguruar që procedurat të ndjekin standardet më të larta për cilësi dhe transparencë. Gjithashtu, gjykata

do të punoj në ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe stafit administrativ për të aplikuar me kompetencë udhëzimet dhe procedurat e planit, për të përbushur qëllimet e drejtësisë efektive dhe të qasshme për të gjitha palët.

XXIII. Ruajtja dhe arkivimi i lëndëve brenda gjykatës si dhe dorëzimi i lëndëve të cilat i plotësojnë kushtet, në agjensinë shtetërore të arkivave

Gjykata Themelore në Gjilan duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren për Arkivat, do të sigurojë ruajtjen dhe arkivimin e rregullt të lëndëve brenda gjykatës, duke përfshirë dorëzimin e lëndëve që i plotësojnë kushtet për arkivim në Agjencinë Shtetërore të Arkivave. Kjo do të bëhet në përputhje me standartet ligjore dhe procedurat e përcaktuara për menaxhimin dhe ruajtjen e të dhënave gjyqësore, me qëllim sigurimin e integritetit dhe disponueshmërisë së dokumenteve për nevojat e ardhshme gjyqësore. Gjykata do të angazhohet në arkivimin e përhershëm dhe të përshtatshëm të lëndëve, në përputhje me afatet e përcaktuara dhe kërkesat për dorëzimin e dosjeve të mbyllura në Agjencinë e Arkivave. Ky proces do të monitorohet rregullisht për të siguruar që çdo dosje e përfunduar dhe të gjitha aktet përkatëse të dorëzohen në përputhje me rregullat dhe standartet e ruajtjes së dokumenteve, me çrast gjykata jonë pritet që gjatë vitit 2025 rreth 7500 lëndë ti dërgoj në Arkivin Ndërkomunal të Qytetit.

XXIV. Zbatimin e rekomandimeve që dalin nga raportet inspektuese të përgatitura nga NJIGJ të cilët monitorojnë punën e gjyqësorit.

Gjykata Themelore në Gjilan do të implementojë në mënyrë rigoroze rekomandimet e dalë nga raportet inspektuese të përgatitura nga NJIGJ, e cila ka për qëllim monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqësorit. Kjo përfshin hartimin e raporteve të brendshme që do të pasqyrojnë procesin e zbatimit të rekomandimeve, duke siguruar një vlerësim të qartë të përparimit dhe mbikëqyrjen e ndërmarrjes së masave për përmirësimin e efikasitetit të procesit gjyqësor. Gjykata do të sigurojë një analizë të detajuar të implikimeve që mund të lindin gjatë implementimit dhe do të ndërmarrë hapa të përshtatshëm për adresimin e çdo sfide që mund të paraqitet, me qëllim optimizimin e cilësisë së shërbimeve dhe rritjen e besueshmërisë ndaj sistemit gjyqësor.

XXV. Zbatimin e rekomandimeve që dalin nga raportet e përgatitura nga monitorimet e realizuara nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore, të cilat monitorojnë punën e gjyqësorit, si dhe planeve për adresim të rekomandimeve nga KGJK.

Gjykata Themelore në Gjilan do të zbatojë rekomandimet që dalin nga raportet e monitorimeve të realizuara nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore, të cilat mbikëqyrin punën e gjyqësorit,

dhe do të adresojë planet për implementimin e këtyre rekomandimeve, në përputhje me udhëzimet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). Rekomandimet e këtyre organizatave janë të rëndësishme për avancimin e praktika gjyqësore, duke mundësuar një menaxhim më të mirë të proceseve dhe përmirësimin e strukturave të brendshme të gjykatës.

XXVI. Zbatimi i udhëzuesit për politikën ndëshkimore me qëllim të krijimit të praktikës së uniformitetit në shqiptimin e dënimive brenda sistemit gjyqësor.

Në kuadër të zbatimit të Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, i cili ka për qëllim krijimin e praktikës së uniformitetit në shqiptimin e dënimive, Gjykata Themelore në Gjilan do të fokusohet në implementimin e udhëzuesit me qëllim që të sigurojë një qasje të qëndrueshme dhe të barabartë në shqyrtimin e rasteve, veçanërisht përsa i përket vlerësimit të rrethanave lehtesuese dhe rënduese, si dhe përcaktimin e dënimive në përputhje me parimet e përcaktuara nga Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore të Gjykatës Supreme.

XXVII. Zbatimi i udhëzuesit për referimin e rasteve në procedurë të ndërmjetësimit si mjet alternativ për zgjidhjen e lëndëve.

Gjykata Themelore në Gjilan deri më tanë ka një praktikë të mirë të zgjidhjes së lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit sidomos në lëminë penale ndërsa në lëminë civile synojmë që të rrisimi numrin e lëndëve të zgjidhura përmes kësaj procedure.

XXVIII. Zbatimi i udhëzuesit për shpërndarjen e shkresave duke evitar mundësinë e dështimit të seancave.

Në kuadër të zbatimit të udhëzuesit për shpërndarjen e shkresave, Gjykata Themelore në Gjilan do të sigurojë shpërndarjen e të gjitha shkresave, njoftimeve dhe akteve të tjera në mënyrë të rregullt dhe efikase, për të parandaluar mundësinë e dështimit të seancave. Përmes implementimit të këtij udhëzuesi, gjykata do të fokusohet në garantimin e dërgimit të dokumenteve në kohë, duke përfshirë njoftimet për palët, të cilat duhet të jenë të përpiluara dhe të shpërndara pa vonesa. Në këtë kuadër, Gjykata Themelore në Gjilan do të përdorë metodat më të avancuara për shpërndarjen e dokumenteve dhe do të sigurojë që çdo akt dhe njoftim të arrijë në duar të duhur përpara seancave gjyqësore. Kjo përfshin dorëzimin nëpërmjet postës, emailit, si dhe mundësitë e tjera të përcaktuara nga legjislacioni përkatës, duke siguar se të

gjitha palët përfshilen në procesin e shqyrtimit të çështjeve. Gjithashtu, do të bëhet monitorim i vazhdueshëm i këtij procesi për të verifikuar se nuk ka gabime apo vonesa që mund të çojnë në dështimin e seancave, duke garantuar efikasitetin dhe transparencën e veprimtarisë gjyqësore. Ky proces do të mbështetet nga dorëzuesit e dedikuar në gjykatë dhe është pjesë e angazhimit të gjykatës për të ofruar një administratë të drejtësisë të shpejtë dhe të saktë.

XXIX. Hartimi i planit për monitorimin e punës së gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve dhe administratës nga Kryetari i Gjykatës.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, do të hartojë një plan të detajuar për monitorimin e punës së gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve dhe administratës, i cili do të fokusohet në vlerësimin dhe optimizimin e angazhimit të çdo individi në funksionimin e duhur të gjykatës. Ky plan do të përfshijë sistemimin e detyrave dhe përgjegjësive të stafit, si dhe ndjekjen e performancës së tyre për të siguruar që lëndët të trajtohen në përputhje me normat dhe standartet e përcaktuara. Për t'u siguruar që ky proces të jetë sa më efektiv, plani do të plotësohet/ndryshohet dhe përditësohet sipas nevojës, duke marrë parasysh lëvizjet eventuale të stafit dhe ndryshimet që mund të ndodhin brenda gjykatës. Kryetari do të angazhohet në një mbikëqyrje të vazhdueshme për të siguruar që të gjitha funksionet dhe procedurat të realizohen në mënyrë të koordinuar dhe efikase, me qëllim përmirësimin e performancës dhe produktivitetit të gjykatës.

XXX. Hartimi i raporteve periodike për KGJK-në bazuar në rezultatet e treguara, si dhe sfidave eventuale të paraqitura gjatë punës brenda gjykatës.

Gjykata Themelore në Gjilan do të hartojë raporte periodike tremujore (tremujori I, II, III, dhe IV) për të pasqyruar në mënyrë të detajuar punën, rezultatet e arritura dhe sfidat eventuale që mund të paraqiten gjatë periudhës së raportimit. Këto raporte do të përfshijnë informacion të plotë mbi ecurinë e punës së gjykatës, përfshirë lëndët e trajtuar, performancën e gjyqtarëve, çështje administrative dhe teknike, si dhe sfidat që mund të ndikojnë në funksionimin e përditshëm të gjykatës. Raportet do të dërgohen në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) në mënyrë të rregullt dhe do të paraqesin një pasqyrë të qartë për progresin e arritur dhe nevojat e mundshme për përmirësim dhe për të njëjtat do të raportoj Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan apo edhe nënkyretari i kësaj gjykate.

XXXI. Hartimi i raporteve lidhur me zbatimin e rekomandimeve të pranuara nga NJIGJ.

Plani dhe Programi i Punës 2025

Gjykata Themelore në Gjilan në përputhje me kërkesat dhe angazhimet për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së administratës dhe sistemit gjyqësor, do të hartoje në fund të çdo periudhe tre mujore të punës, raporte lidhur me zbatimin e rekomandimeve të pranuara nga Njësia e Inspektimit Gjyqësor. Raportet do të përfshijnë një analizë të detajuar të progresit në zbatimin e rekomandimeve, sfidave që mund të kenë lindur gjatë procesit dhe hapave të ardhshëm që do të merren për të siguruar një realizim të plotë dhe të suksesshëm të rekomandimeve.

XXXII. Hartimi i raporteve që dalin nga monitorimet e realizuara nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore e të cilat udërlidhen me punën e gjykatës, si dhe planeve për adresim të rekomandimeve nga KGJK.

Gjykata Themelore në Gjilan do të hartoje raporte të detajuara që do të dalin nga monitorimet e realizuara nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore, të cilat lidhen me punën e gjykatës. Këto raporte do të shërbejnë për të vlerësuar implementimin e rekomandimeve dhe për të siguruar që veprimet e nevojshme për përmirësimin e procesit gjyqësor të merren në kohë. Gjykata jomë do të përgatitë gjithashtu plane konkrete për adresimin e rekomandimeve nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), duke siguruar që këto rekomandime të integrohen në praktikat dhe procedurat e brendshme të gjykatës. Raportet dhe planet e adresimit do të monitorohen rregullisht për të siguruar zbatimin e rekomandimeve dhe për të garantuar përparimin në përmirësimin e cilësisë së punës gjyqësore.

XXXIII. Hartimi i raporeteve për numrin e seancave të mbajtura, seancave të shtyera dhe seancave të anuluara.

Gjykata Themelore në Gjilan për të siguruar një monitorim të rregullt dhe të qartë të ecurisë së seancave gjyqësore, edhe tanë harton raporte mujore lidhur me numrin e seancave të mbajtura, seancave të shtyera dhe ato të anuluara por kjo praktikë synohet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2025. Raporti do të përbajë detaje të plota mbi arsyet që kanë çuar në shtyrjen apo anulimin e seancave, përfshirë faktorë si mungesa e palëve, arsyet shëndetësore, vështirësitet administrative apo çështjet teknike.

XXXIV. Hartimi i raporeteve periodike dhe vjetore të punës së kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarëve mbikëqyrës të degëve sipas formatit të përcaktuar me aktet e KGJK-së.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan do të hartoje plane periodike për vlerësimin e punës së tij, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregulloren për Vlerësimin e Punës së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, KGJK Nr.13/2022, Neni 10, paragrafi 1. Këto plane do të përfshijnë analiza të detajuara të realizimit të detyrave dhe përgjegjësive të tij si kryetar, duke vlerësuar performancën në aspektet e organizimit të punës, administratës dhe menaxhimit të resurseve. Kryetari do të adresojë sfidat që mund të ndikojnë në efikasitetin dhe funksionimin e gjykatës dhe do të paraqesë rekomandime për përmirësimin e proceseve dhe rritjen e cilësisë së punës së gjykatës. Raportet do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e aktiviteteve të ardhshme dhe përmirësimin e drejtimit të institucioneve gjyqësore.

XXXV. Ndihma Juridike Ndërkombëtare

Kryetari i Gjykatës Themelore, vendos në çdo rast kur kërcohët ndihma juridike ndërkombëtare (*përveç kur për kërkesë duhet të vendos kolegji*) dhe për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja, si dhe në rastet e tjera kur me ligj është përcaktuar kompetenca e kryetarit të Gjykatës Themelore si dhe i njëjti do të angazhohet edhe në lëndë civile dhe penale.

XXXVI. Caktimi i shqyrtimeve gjyqësore dhe publikimi i orarit të mbajtjes së tyre

Shqyrtimet gjyqësore caktohen nga gjyqtarët, përkatësisht kryetarët e trupave gjykuese konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Orari i seancave gjyqësore regjistrohet në SMIL dhe njëkohësisht publikohet në ueb portalin gjyqësor.

XXXVII. Orari i Punës dhe Respektimi i Kodit të Mirësjelljes

Orari i punës në gjykatë fillon në ora 08:00 h dhe zgjatë deri në ora 16:00 h, ndërsa pushimi ditor shfrytëzohet nga ora 12:00 h deri në ora 13:00 h, në rast pamundësie të shfrytëzimit të pushimit brenda këtij orari, pushimi ditor mund të shfrytëzohet edhe jashtë këtij orari, por vetëm për të njëjtën ditë.

Të gjithë të punësuarit në Gjykatën Themelore në Gjilan, janë të obliguar që gjatë orarit të punës në ushtrimin e pozitës zyrtare, të sillen në mënyrë korrekte, duke respektuar Kodin e Mirësjelljes për Personelin e Administratës Gjyqësore, njëkohësisht Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar, të respektojnë orarin, vendin dhe detyrat e punës.

Plani dhe Programi i Punës 2025

Veshja dhe paraqitja e të gjithë zyrtarëve të gjykatës, duhet të jenë serioze, për ta përfaqësuar sa më denjësisht institucionin në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Përdorimi apo aktivitetet e zyrtareve te gjykatës, përfshirë gjyqtarët në rrjetet sociale duhet të jenë të përgjegjshme dhe të paraqiten në mënyrë korrekte, ndërsa vendosja e fotografive dhe postimeve të ndryshme, duhet të jetë e kujdeshme në nivelin e paraqitjeve korrekte.

XXXVIII. Trupi për Menaxhimin e Krizave

Trupi Menaxhues i Krizave i Gjykatës Themelore në Gjilan, do të jenë në përbërja nga: Kryetari i Gjykatës – Udhëheqës i Trupës Menaxhuese, Gjyqtarët Mbikëqyrës të Degëve dhe do të shërbejë për Menaxhimin e Krizave e Gjykatës Themelore në Gjilan në raste dhe situatat emergjente shëndetësore, katastrofat natyrore, kërcënimëve të sigurisë apo rrethana të tjera të natyrave të ngjashme në të ardhmen.

XXXIX. Transparencia dhe llogaridhënia

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënieς, si dhe duke u bazuar edhe në Strategjinë e Komunikimit ti miratuar nga KGJK-ja për një gjyqësor më transparent dhe të qasshëm, gjykata do të informojë publikun rregullisht mbi punën dhe aktivitetet e gjykatës. Publiku në baza ditore do të kenë qasje në orarin e seancave gjyqësore të çështjeve penale, civile apo të kundërvajtjes i cili do të publikohet në ueb faqen e gjykatës. Po ashtu publiku do të ketë qasje në statistikat e gjykatës, raportet e punës, statistikat e përformancës së gjyqtarëve, plani dhe programi vjetor i punës do të jenë të qasshme për të gjithë, me çka publikut do t'i mundësohet qasje e gjerë në aktivitetet e gjykatës, për të cilat publiku njëkohësisht do të mund të informohet edhe përmes rrjetit social Facebook.

Ueb faqja e gjykatës po ashtu ofron mundësinë edhe për kërkimin e Statusit të Lëndës dhe njëkohësisht aplikimin online të qytetarëve për certifikatën mbi dënimë penale.

Të gjitha aktgjykimet penale, civile dhe të gjitha aktvendimet meritore, do të publikohen në ueb portalin gjyqësor të Republikës së Kosovës, konform Ligjit për Gjykatat, dispozitave të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

XL. Administrata Gjyqësore

Menaxhimi i punëve administrative, teknike dhe të sigurimit të objekteve do të bëhet nga U.d i administratorit të Gjykatës Themelore në Gjilan, shefat përkatës, ndihmës administratorët (për degët) të cilët janë të detyruar që ti raportojnë u.d të administratorit për punën e tyre, i cili njëherit e mbikëqyr punën e tyre menaxheriale, kurse administratorja ka obligim që ti raportojë kryetarit të gjykatës.

U.d i administratorit dhe ndihmës administratorët së paku çdo 3 (tre) muaj do të mbajnë takime për të diskutuar dhe vodosur për çështje që ndërlidhen me kompetencat e tyre.

U.d i administratorit për çdo javë do të mbajë mbledhje me shefat e zyrave përkatëse e gjithashtu më së paku 1 herë në javë edhe me kryetarin e gjykatës apo edhe më tepër se njëherë në javë varësisht nga nevoja.

I gjithë stafit administrativ i Gjykatës Themelore në Gjilan, detyrohen që ta respektojnë orarin e punës, detyrat e punës dhe vendin e punës dhe gjatë orarit të punës duhet që ti mbajnë me vete në vende të dukshme dhe ti kenë gjithmonë kartat zyrtare të identitetit dhe për këto obligime duhet të i mbikëqyr administratorja e gjykatës dhe ndihmës administratorët për degët.

Plani dhe Programi i Punës 2025

XLI. Synimet e përektuar nga ana e gjykatës

		Minimumi i caktuar nga KGJK	Synimi i caktuar nga Gjykata
I.	Reduktimi i lëndëve sipas planit strategjik per qasje ne drejtësi 2022-2025	20%	30%
II	Reduktimi i lëndëve te vjetra	20%	30%
III.	Realizimi i normës së punës së gjyqtarëve	100%	100%
IV.	Realizimi i normës se punës së bashkëpuntorëve profesional	100%	100%
V.	Ngritura e cilësisë se vendimmarjes respektivisht zvogëlimi i numrit të lëndëve të kthyera në rigjykim	20%	20%
VI.	Rritja e numrit të vendimeve të publikuara	30%	50%
VII.	Rritja e numrit të seancave bllok në trajimin e lëndeve	30%	50%
VIII.	Planifikimi i seancave dhe zvogëlimit të numrit të seancave të shtyra dhe të anuluara	20%	50%

Plani dhe Programi i Punës 2025

IX.	Rritja e kualitetitit të të dhënave në raport me regjistrimin e lëndëve e deri në përfundim të lëndëve duke harmonizuar dosjen elektronike me dosjen fizike me të gjitha veprimet procedurale te ndërmarrা	95%	95%
X.	Vendosja e drejtë e vendimeve gjyqësore në regjistrin e Evidencës Penale	100%	100%
XI.	Zbatimi i planit për drejtësi procedurale	100%	100%
XII.	Regjistrimi i plotë i të gjitha lëndëve në arkiv	100%	100%

XLII. Ndryshimi eventual i këtij plani

Duke pasur përasysht qëllimet e këtij plani, kryetari i kësaj gjykate mund të vendos me vendime të posaçme që gjyqtarët të caktuar të ngarkohen me lëndë shtesë, lëvizjen e gjyqtarëve nga një departament në tjetrin, lëvizjen e gjyqtarëve nga qendra në degë dhe anasjelltas gjithnjë me qëllim të ngritjes së efikasitetit të kësaj gjykate duke vepruar edhe me nevojat që mund të paraqiten brenda vitit 2025.

Sa i përket degëve të kësaj gjykate, përkatesisht lëndëve të cilat rrjedhin nga kontratat kolektive mund të vendoset që të njëjtat lëndë të përfundohen nga gjyqtarët e kësaj gjykate në Gjilan, por kjo varet nga efikasiteti në tre muajt e parë të vitit 2025 si dhe arritjeve të lëndëve të reja të kësaj natyre gjatë këtij viti.

Me rastin e caktimit të gjyqtarëve nga Gjykata Themelore në Gjilan në degët e saja, apo anasjelltas kryetari i gjykatës, sipas nevojës në konsultim me gjyqtarët do të vendos për caktimet tilla, pasi që në takimet e zhvilluara të gjithë gjyqtarët pa përjashtim janë dakodruar që për interes të përgjithshëm dhe me qëllim të ngritjes së efikasitetit mundë të lëvizin.

XLIII. Zbatimi

Ky plan i punës do të filloj të zbatohet nga data 15 janar 2025.